



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Gramsh më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Blerje materiale ndertimi, hidraulike, elektrike etj , marreveshje kuader me afat 2- vjecar

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
Materiale ndërtimi 44110000-4

**VLERA E FONDIT LIMIT: fond limit 22 046 460 (njëzet e dy milion e dyzet e gjashte mije e katerqind e gjashtedhjetë) lekë pa TVSH** Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 229 986,021 euro pa tvsh. Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 08.04.2026 eshte 95.86

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kritereve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kritereve si vijon:

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*2.1.1. Sipas kritereve të përgjithshme të për zgjedhjes/kualifikimit, Shtojca 8 në DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2023,2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në piken 2/a citohet: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit43, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërsa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Vendosja e ketij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, ne nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

*Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP(i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 date 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. AK mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë: 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit nr. 29, të ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **e maturuar (duke përfshirë këtu edhe këstet e maturuara për vitin 2026)** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.  
*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

---

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të se ciles merr përsipër të kryej shërbimin e transportit dhe dorëzimin e mallrave /artikujve objekt prokurimi pranë vendeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe të marrin përsipër shërbimin e transportit si dhe dorëzimin e mallit në vendet e caktuara nga autoriteti kontraktor. Deklarata është dëshmi që vërteton marrjen e përgjegjesive nga operatorët ekonomikë dhe krijon një besueshmeri dhe siguri për autoritetin, për furnizimin dhe transportimin e materialeve të ndërtimit pranë çdo pike të përcaktuar.

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë të pakten 3 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet të ketë në pronësi ose me qera

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
-----	--------	-------	---------

1	Mjet transporti me vinc me kapacitet mbajtes nga 3.5-5 ton	1	Pronesi ose me qira
2	Mjet transporti me vinc me kapacitet mbajtes nga 6-7.5ton	1	Pronesi ose me qira
3	Mjet transporti me kapacitet mbajtes deri 1 ton	1	Pronesi ose me qira

- ❖ Per mjetet qe jane ne pronesi duhet te paragiten dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; certifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshem.
- ❖ Per mjetet qe jane me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i permbushur me vete deklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sip 3 shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbajë kerkesat e autoritetit. Autoritetit/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimi të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të **Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”**, dhe nenit 40, pika 5/ç, të **VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, ky kriter kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion, ose mund t’u vihen në dispozicion, mjetet e nevojshme për përmbushjen e kontratës.

Numri dhe lloji i mjeteve janë vlerësuar të nevojshme duke marrë parasysh:

- Natyra dhe përmasat e kontratës;
- Vendndodhjet ku do të dorëzohet malli, me një shtrirje të gjerë gjeografike në disa njësi vendore të bashkisë;
- Kohëzgjatja e furnizimit dhe nevoja për transport të vazhdueshëm dhe të sigurt.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te deklaroje qe ne momentit e dorezimit ,cdo mall te jete sipas standarteve CE/ekuivalent dhe te plotesoje respektivisht specifikimet e kerkuara

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, date 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit për te verifikuar permbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi sipas standardeve.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese prane AK-Së ne daten dhe oren e hapjes se ofertave nga nje muster fizike per materialet e paraqitura ne shtojcen e publikuar ne SPE  
Mos paraqitja e mostrave ose paraqitja me mangesi eshte kusht per skualifikim

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36, dhe 77. të ligjit nr.162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nën të 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomike pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi. për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike. Numri i mostrave të kërkuara është një numër minimal duke parë sasinë e madhe të preventivit dhe perzgjedhja e tyre është bërë bazuar në rëndësinë dhe sasinë e konsiderueshme të tyre. Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë staf minimalisht me 5 persona në datën e hapjes së ofertave e dokumentuar me vertetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore. 2 (dy) prej të cilëve duhet të jenë shoferët

Për shoferët duhet të paraqiten:

- Certifikatën e aftësisë Profesionale të leshuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimeve të transportit rrugor
- Leje drejtimi e leshuar nga Dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Kontrata e punës

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nën të 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "T'ar prokurimin publik" dhe nën të 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, date 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i kërkuar i punonjësve është përllëgojë bazuar në sasinë e mallrave të caktuara në preventiv dhe numrin e nevojshëm të mjeteve që kemi kërkuar nga operatori ekonomik. Shoferët janë të nevojshëm për transportimin e mallrave me mjetet nga operatori ekonomik drejt vendit të caktuar nga autoriteti kontraktor. Punonjësit e tjerë është parë e arsyeshme të kërkojnë pasi duhet të merren me ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetdeklarimit

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te kete njesi shitje e tregtimi te mallrave objekt prokurimi ne pronesi ose me qira e vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronesie ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e QKR) per keto njesi

**Argumentimi:** Ky kriter kërkohet për të siguruar që operatori ekonomik ka kapacitete fizike për të kryer aktivitetin e kontraktuar, duke garantuar:

- Disponueshmërinë reale të hapësirave për tregtim/shitje;
- Përbushjen e kontratës në mënyrë të pandërprerë;
- Sigurinë ligjore për qiradhënien ose pronësinë e njësive, sipas Kodit Civil dhe regjistrave zyrtarë

### **Shënim:**

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga komisioni i ngritur me me Urdhërin e Zyrtarit te Autorizuar N/Kryetarit të Bashkisë nr.413 datë 02.12.2025, për ngritjen e “Komisionit për përcaktimin e sasive, hartimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit Limit”, me objekt prokurimi “Për blerjen e materialeve të ndërtimit”.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**

**Loina Zogu**

**Julian Muha**

**Kleo Hoxha**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR  
ZV/KRYETARI I BASHKISË**

**XHILSON BAJRAMI**